

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-92/13**

**Prishtinë,  
2 prill 2014**

Në çështjen juridike të:

**D S  
N S  
S**

***Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese***

kundër.

**N A  
K  
P**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Dag Brathole dhe Erdogan Haxhibeqiri, Anëtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/156/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA50069), të datës 6 qershor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 2 prill 2014, mori këtë

## AKTGJYKIM

1. Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/156/2012, (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA50069), i datës 6 qershor 2012, pasi që është marrë jashtë juridiksionit të KKPK-së.
2. Hidhet poshtë si e papranueshme kërkesa KPA50069 e D S .

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 2 tetor 2007, pala ankuese, me pas paraqitësi i kërkesës D S ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (KPA) ku ka kërkuar konfirmimin e të drejtës së tij pronësore mbi një tokë që ndodhet në zonën e Prizrenit, fshati Korishë, ngastra kadastrale 717, me sipërfaqe prej 50 ari – në tekstin e mëtejme prona e kontestuar apo prona.
2. Ai ka pohuar se prona i takon familjes së tij në bazë të një vendimi të gjykatës për kthimin e tokës – lënda nr. 504/1997 në Gjykatën Komunale në Prizren.
3. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur në Komision një kontratë të vitit 1961 për shitjen e pronës kontestuese nga S S tek Komuna e Prizrenit. Siç është pretenduar, kontrata është vërtetuar (kontrata numër 659/62, me datë 11 prill 1962) në shkrimoren e Gjykatës Komunale në Prizren.
4. Në vitin 1997, kontrata është shpallur nule dhe e pavlefshme – me vendim të Gjykatës Komunale në Prizren, më 17 mars 1997, lënda numër 444/1995, i cili ka hyrë në fuqi më 9 qershor 1997.
5. Në rastin tjetër, Gjykata Komunale në Prizren ka vendosur se ngastra numër 61 (një tjetër nga prona, që është objekt i rastit në fjalë - ngastra 717) duhet t'i kthehet në posedim familjes së paraqitësit të kërkesës – më saktësisht paraardhësve të supozuar të tij S Z , S D dhe V Z – vendimi i datës 23 shtator 1998, i marrë për lëndën numër 504/1997 (i përmendur tashmë në pikën 2 si më lartë).
6. Është vërtetuar se ngastra nr. 717 (sipas numërimit të vitit 1962 dhe 1997) ndodhet në kadastër me numër 3340 dhe është e regjistruar si tokë komunale – Komuna e Prizrenit.
7. Pavarësisht nga numri i ri kadastral, njoftimi në rastin në fjalë është bërë në pajtim me gjendjen aktuale kadastrale dhe shenja e njoftimit është vendosur në ngastrën e re nr. 717 (e cila nuk është ngastra kontestuese). Si rezultat i kësaj, personi që posedon ngastrën aktuale nr. 717, me emrin N A është përfshirë në procedurë në KKPK.

8. Pala përgjegjëse në kërkesë, N A , ka pohuar se familja e tij gjithmonë e ka pasur në posedim ngastrën nr. 717. Megjithatë, është vërtetuar se kjo ngastër nuk ka asgjë të bëjë me atë që është kërkuar nga D S , prandaj pozicioni i palës përgjegjëse në kërkesë ishte krejtësisht jo relevant rreth kërkesës.
9. KKPK-ja e ka refuzuar kërkesën. KKPK-ja ka pranuar se vendimi i gjykatës në rastin nr. 504/1997 nuk i referohet pronës së kërkuar; e njëjta është regjistruar si pronë shoqërore. KKPK-ja nuk ka marrë parasysh efektin ligjor të vendimit të marrë në lëndën nr. 444/1995 me të cilin kontrata e vitit 1962 për shitblerje të ngastrës nr. 717 (tani 3340) është shpallur nule dhe e pavlefshme.
10. Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 13 mars 2013. Ai ka paraqitur ankesë më 3 prill 2013.
11. Pala përgjegjëse në kërkesë nuk është përgjigjur në ankesës.

**Pretendimet e palës ankuese:**

12. Pala ankuese pohon se ai e ka dëshmuar të drejtën e tij pronësore. Ai pretendon se familja e tij ia kishte shitur pronën Komunës së Prizrenit në vitin 1962, por më vonë kjo kontratë është shpallur nule dhe e pavlefshme me vendimin e gjykatës që është marrë në lëndën nr. 444/95. Ai pretendon se e ka humbur pronën për shkak të konfliktit të armatosur dhe se nuk ekziston asnjë arsye që kërkesa e tij të refuzohet.

**Arsyetim ligjor:**

**Pranueshmëria e ankesës:**

13. Ankesa është pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afati prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, për zgjidhjen e kërkesave pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale (në tekstin e mëtejshëm Ligji).

**Vlefshmëria e vendimit të kundërshtuar dhe juridiksioni:**

14. Vendimi i KPPK-së është dashur të anulohet pasi është marrë në mungesë të juridiksionit.
15. Sipas nenit 3.1 të Ligjit, Komisioni ka kompetencë për zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999, kërkesat lidhur me të drejtat që nuk mund të

- ushtrohen për shkak të rrethanave që drejtpërsëdrejti ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
16. Në rastin konkret është vërtetuar se në vitin 1962 paraardhësi i paraqitësit të kërkesës ia ka shitur ngastrën nr. 1 717 (tani 3340) Komunës së Prizrenit. Vërtetohet se përmes vendimit të gjykatës i datës 17 mars 1997 i marrë për lëndën me numër 444/1995 në Gjykatën Komonale në Prizren, kjo kontratë është shpallur nule dhe e pavlefshme sipas nenit 8a të Ligjit për Qarkullimin e Pronës së Paluajtshme të vitit 1981 (Gazeta zyrtare e RSS-së nr. 43/81, i ndryshuar në vitin 1987 – Gazeta zyrtare e RSS-së nr. 28/1987). Vendimi nuk është kundërshtuar dhe ka hyrë në fuqi më 9 qershor 1997 (sipas vulës së verifikimit të Gjykatës Komonale në Prizren).
  17. Pasojat ligjore të pavlefshmërisë në atë kohë kanë qenë të rregulluara me nenin 104 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 29/1978). Sipas nenit 104 po aty, në rast pavlefshmërie secila palë kontraktuese duhet ta kthejë atë çka ka pranuar mbi bazën e asaj kontrate, përveç nëse natyra e kontratës do të parandalonte një kthim të tillë, gjë që nuk ka ndodhur në rastin konkret.
  18. Si rrjedhojë e vendimit të pavlefshmërisë, e drejta pronësore mbi ngastrën nr. 717 (tani ngastra nr. 3340) i është kthyer pronarit të parë Stojanović Sava *patrimonium* (të gjitha të drejta dhe detyrimet) (apo tek trashëgimtarët e tij, nëse në kohën e marrjes së vendimit ai veçse kishte vdekur, që është edhe rasti në fjalë).
  19. Nëse paraqitësi i kërkesës është njëri nga trashëgimtarët e S S , që mund të dëshmohet nga të dhënat në dosje të lëndës, ai po ashtu ka të drejtë mbi këtë pronë brenda kufijve të të drejtave të tija trashëguese (dhe në këtë rast, konkludimi i KKPK-së se nuk ekziston asnjë provë që prona i është kthyer familjes së S S në vitin 1997, ishte i gabueshëm).
  20. Sidoqoftë, së pari nuk ekzistojnë të dhëna se cilët janë kufijtë e të drejtave trashëguese të paraqitësit të kërkesës dhe së dyti, faktet siç shihen nga gjykata përjashtojnë mundësinë që kjo pronë të jetë humbur për shkak të konfliktit të armatosur në vitet 1998/1999.
  21. Përveç kësaj, nuk ekziston asnjë nënkuptim se Komuna e Prizrenit apo ndonjë person tjetër konteston faktin se ish-ngastra nr. 717, e cila tani është ngastra nr. 3340 i është kthyer familjes së S S . Pala përgjegjëse në kërkesë N A uzurpon një ngastër e cila nuk ka të bëjë asgjë me ngastrën që është objekt i kontestit aktual, e cila sipas regjistrimit të ri kadastral është me nr. 3340.
  22. Prandaj çështja në këtë rast është se ngastra – 3340 (ish 717) është ende e regjistruar si tokë e komunës në regjistrin e pronave.
  23. Ndërsa, ajo që nevojitet të bëhet është që regjistri për pronat e paluajtshme të korrigjohet në pajtim me të drejtat e trashëgimtarëve të S S .

24. Faktet e vërtetuara në përgjithësi shpijnë tek i vetmi përfundim se nuk ekziston asnjë kontest prone që ndërlidhet me konfliktin e armatosur të viteve 1997/1999. Dhe, lënda nuk është në kuadër të juridiksionit të KKPK-së dhe të Kolegjit të Apelit i Gjykatës Supreme. Prandaj, Gjykata është dashur ta prish vendimin dhe ta hedhë poshtë ankesën.
25. Në bazë të të lartcekurave dhe në përputhje me nenin 12.2 të Ligjit dhe nenin 198.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Gjykata vendosi si në dispozitiv.

### **Këshillë ligjore**

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it**

**Erdogan Haxhibeqiri, Gjyqtar**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**